



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 08. 03. 2010, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini Nexhat Daci dhe Sllobodan Petroviq.

Mungoi: Enis Kervan.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Ramaj - KDI, Albana Bylykbashi – MPJ dhe përfaqësues të medieve.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të 27 janarit dhe të 24 shkurtit 2010;**
- 3. Amendamenti i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbaleve të 27 janarit dhe të 24 shkurtit 2010

Procesverbalet e mbledhjeve të 27 janarit dhe të 24 shkurtit 2010 u miratuan njëzëri.

3. Amendamenti i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare

Sabri Hamiti - Për shqyrtimin e Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare Komisioni e ka formuar grupin e punës. Në këtë P/ligj, deputeti Riza Smaka i propozoi 4 amendamente. Grupi i punës e shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara nga deputeti R. Smaka, për të cilat do të njoftojë referuesi i grupit, Ibrahim Gashi.

Ibrahim Gashi – E njoftoi Komisionin se grupi i punës i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga deputeti Riza Smaka dhe e përkrahu amendamentin 1, kurse amendamentet 2, 3 dhe 4 nuk i përkrahu, meqë nuk i konsideronte përmbajtjesore.

Teksti i Projektligjit është i mirë dhe nuk ka nevojë për shumë amendamente, megjithatë i kemi propozuar disa amendamente.

Propozohet që në nenin 1.2 të hiqen fjalët: “ashtu siç përcaktohet në këtë Ligj.”, sepse konsiderohen të panevojshme.

Në nenin 2 është propozuar të hiqen paragrafët 8, 9 dhe 10, në të cilët përkufizohen fjalët *eksport*, *import* dhe *institucion financiar*, sepse mendohet se përkufizimi i këtyre termave të përgjithshëm nuk ka vend në këtë Projektligj, ngase i kemi pasur më parë në ligjet tona si legjislativ.

Në nenin 6 pas fjalëve “në nenin 3 të këtij Ligji”, është propozuar të hiqet krejt teksti, sepse konsiderohet se është përmendur në nenin 1 të Projektligjit.

Po ashtu është rekomanduar që teksti i Projektligjit t’i nënshtrohet redaktuarës gjuhësore dhe të harmonizohen variantet gjuhësore të tekstit të Projektligjit.

Sabri Hamiti - Propozoi që Komisioni së pari t’i shqyrtojë amendamentet e propozuara nga deputeti Riza Smaka.

Komisioni pas shqyrtimit të amendamenteve të propozuara nga deputeti Riza Smaka e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Nga amendamentet e propozuara të deputetit Riza Smaka nuk përkrahen amendamentet 2, 3 dhe 4, ndërsa përkrahet amendamenti 1, si vijon:

1. Në amendamentin e nenit 1 të LZSN-së të bëhen këto plotësime dhe ndryshime:

Qëllimi i Ligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare (në vijim: LZSN) është:

- sigurimi i zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës;*
- krijimi i kushteve për Republikën e Kosovës për të kontribuar me efikasitet dhe me efektivitet për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare;*
- luftimi i terrorizmit ndërkombëtar;*
- luftimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive të njeriut;*
- zgjidhja paqësore e konflikteve territoriale ndërmjet shteteve të ndryshme, si dhe*
- realizimi i interesave të sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës.*

Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga grupi i punës dhe e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohen amendamentet dhe rekomandimet e propozuara nga Grupi i punës në Projektligjin për zbatimin e sanksioneve penale, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1.2 hiqen fjalët: ”ashtu siç përcaktohet në këtë Ligj.”

Amendamenti 2

Në nenin 2 hiqen paragrafët 8, 9 dhe 10.

Amendamenti 3

Në nenin 6, pas fjalëve “në nenin 3 të këtij Ligji”, hiqet i tërë teksti .

Rekomandime të tjera:

1. Tërë teksti i Projektligjit t’i nënshtrohet redaktuarës gjuhësore;
2. Të harmonizohen variantet gjuhësore të tekstit të Projektligjit.

Nexhat Daci - Lidhur me rekomandimet tha se në të gjitha legjislaturat Kuvendi i Kosovës ka qenë i qartë, që ligjet në secilën gjuhë të vijnë në rregull dhe të mos dalin pas seancës plenare pa u përfunduar. E meta më e madhe është se ne ende nuk jemi autoktonë të hartimit të ndonjë ligji dhe në rastet kontestuese midis versioneve mbështetemi në versionin origjinal që nuk është në gjuhën zyrtare.

Ardian Gjini - Mendon se pas miratimit në seancë plenare ligji nuk mund t’i nënshtrohet lekturimit. Propozoi të bëhet praktikë që ligjet, të cilat përcillen për miratim në Kuvend, të mos kenë më nevojë për lekturim.

Sabri Hamiti - Sa u përket gabimeve gjuhësore të projektligjeve është diskutuar disa herë në Kuvend. Ligji është normë, edhe gjuha zyrtare duhet të jetë normë dhe nuk duhet të ketë gabime.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 30

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për mbështetje të Komisionit